

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me date 29.01.2026 ne sallën e Keshillit Bashkiak Bulqize.

Hap mbledhjen Kryetari I Keshillit Bashkiak me keto anetare.

Arben Cupi Edmond Durici Munir Sinani Endrit Meta Gezim Xhafa Behar Cani Greta Tanci
Shkelqim Begu Brulind Sinani Veap Halili Ravjola Kaja Elkier Durici Ernold Cupi Arjan Hoxha

Para miratimit te rendit te dites nga Endrit Meta, Arjan Hoxha dhe Behar Cani per mospjesmarrjen ne komisione te komisionereve duke shprehur qe ky veprim kerkon masa disiplinore si doreheqje. Kryetarja e Bashkise thote qe situatë është e turpshme pasi kur janë bërë ndarjet e komisioneve ka patur vullnet ne kete pike, dua te them qe kush mund te mos vije te terhiqet. Kryetari I keshillit thote qe me miratim te keshillit te bejme ndryshim komisioni. Veap Halili thote qe perpara se te diskutojme komisionet te diskutohet fillimisht ne kryesi sepse ne si komision ekonomie marrim pjese gjithmonë, ndersa komisionet tjera mbajne firma te fallsifikuara. Z.Arben Cupi thoe qe duhet ta vertetosh nese kemi .

1.Hidhet ne votim miratim i rendit te dites me vota pro 11 dhe kunder 2, miratohet. 2.Hidhet ne votim miratimi I procesverbalit te mbledhjes se muajit Dhjetor 2025 date 24.12.2005 me 13 vota pro. Miratohet me 13 vota pro dhe 1 abstenim. 3.Te ndryshme. Endrit Meta shpreh shqetesimin mbi tabelat e vendosura duke thene qe jane kercenuar per permendje emri, ku duhet ta kerkojme kete gje, ta dime si te flasim dhe si te funksionojë. Z.Arben Cupi thote qe kjo gje nuk është lene ne heshtje . Z.Shkelqim Begu thote qe nese pyesim kujt ia vendos vizat e bardha nuk kane informacion, Kush i vendos keto tabela. Albin Bodini ia dha fjalen drejtorit te policise . Shahin Alliu , ne dijenine time ka qene nje komision per vendosjen tabelave ne vitin 2022 ndersa tani nuk kam informacion.. Endrit Meta thote qe ka tabela te vendosura , a ka grup pune per verifikim edhe vizat e bardha, qe te verifikoje kete problem te hasur shpesh. Albin Bodini, nuk kemi nje manual aktualisht si plan per kete , sa kam qene une nuk kane dhene asnje leje per vije. Shkelqim Begu pyet kush I ka vijeuar. Edmond Durici ngre shqetesimin per ujin sepse orari vjen ne oren 6 dhe duhet te vije ne 5. Kryetarja e Bashkise jep dakortesine per ndryshim. Elkier Durici thote qe ne kemi uje vetem nje here ne dite. Kryetarja e Bashkise , jam ne diskutim me ujesjellesin. Edmond Durici gjithashtu flet se ka probleme dhe pedonalja me shume plasje te pllakave duke krijuar gropa. Kryetarja , do e sistemojme sa me shpejt te mundemi. Ernold Cupi thote vajkali nuk ka kryepleq dhe duhet te bejme takime. Kane dhene dy kryepleqe doreheqjen dhe duhen lene takime. Shkelqim Begu thote duhet te zgjidhet sepse jane bere problem kryetari I keshillit sipas opinionit te tij. Ernold Cupi , kopetenca është e keshillit dhe duhet ta beje sekretari I keshillit. Te vendoset data sa me pare. Arben cupi do fillojne procedurat qe neser. Sekretari I Keshillit thote qe nuk kam marre asnje vule qe nga koha qe kam marre detyre. Nga I zgjedhuri si kryeplak ne Vajkal 2, pasi ka dhene doreheqjen por nuk ka sjell vulen.

Korab Kika relatton projekt vendimin ,Fondi shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen . ekonomike 6 perq muaji Dhjetor 2025. Pershkruan te gjithë pikat . Hidhet ne votim me 13 vota pro 1 abstenim.

Z,Korab Kika relatton projekt vendimin mbi kriteret per familjet ne nevoje qe do te trajtohen me fondin e 6 perq gjate vitit 2026. Miratohet me 14 vota pro.

Korab Kika relatton projekt verndimin mbi miratimin e kriterëve per dhenie te ndihmave ekonomike financiare gjate vitit 2026.Hidhet ne votim me 14 vota pro.

Shaqir Izvira relatton projekt vendimin per dhenien ne perdorim te siperfaqes pyroje kullosoe per shesh depozitimi dhe sherbime te tjera sipas lejes minerare 1858/1 date 28.03.2022. Hidhet ne votim me 14 vota pro, miratohet.

Shaqir Izvira relaton projekt vendimin per dhenien ne perdorim te siperfaqes pyroje kullosoe per shesh depozitimi dhe sherbime te tjera sipas lejes minerare 1140 date 28.01.2026. Miratohet me 14 vota pro.

Arben Cupi Edmond Durici Endrit Meta Gezim Xhafa Greta Tanci Shkelqim Begu
Ravjola Kaja Elkie Durici Arjan Hoxha

Mbajtes i procesverbalit

Sekretari I Keshillit Klodian Rec

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 27.02.2026 në sallën e Këshillit Bashkiak si mbledhje e planifikuar jashtë radhe. Hap mbledhjen kryetari i Këshillit Bashkiak z. Arben Çupi. Në mbledhje marrin pjesë këto anëtarë Këshilli: Gëzim Xhafa, Greta Tançi, Raviola Kaja, Brulind Sinani, Ernold Çupi, Edmond Duriçi, Arjan Hoxha, Arjan Pasha, Veap Halili, Ylli Xhafa, Behar Cani, Valbona Jani.

Kryetari i Këshillit ,projektvendim për një shtesë në VKB numër 100 datë 21.12.2025 për miratimin e buxhetit të Bashkisë Bulqizë për vitin 2026. Votohet për miratimin e rendit të ditës dhe miratohet me 12 vota pro.

Votohet për komisionin me pesë anëtarë: Brulind Sinani, Raviola Kaja, Veap Halili, Behar Cani, Arian Hoxha. Relaton Albin Bodini projektvendimin shtesë në VKB nr 100 për miratimin e buxhetit të Bashkisë duke sqaruar përfitimin e fondit nga granti i performancës dhe ndarjen sipas zërave për investim. Hidhet në votim, miratohet me 12 vota pro. Zoti Veap Halili diskuton raportin Këshill dhe Bashki për mbledhjet e Këshillit mbi një koordinim më të mirë të rregulloreve për t'i lënë hapësirë edhe komisioneve. Znj.Kryetare e Bashkisë thotë që për shkak të afatit të fundit që ishte data tre, kjo mbledhje ishte e nevojshme të zhvillohet jashtë radhe. Kryetari i Këshillit lexon betimin për anëtarin e re të Këshillit, znj.Fllanxa Losha. Fllanxa Losha bën betimin ku është miratuar me votra 13 pro.

Greta Tanci, Gezim Xhafa Valbona Jani, Ravjola Kaja, Arjan Hoxha, Arben Cupi, Edmond Durici, Behar Cani, Ylli Xhafa

Mbajtes I Procesverbalit

Sekretari Klodian Reci

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbledhur sot me datë 09.03.2026 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë., mbledhje e shtyrë e datës 06.03.2026. Marrin pjesë këshilltarët: Arben Çupi, Munir Sinani, Valbona Jani, Gëzim Xhafa, Greta Tançi, Brulind Sinani, Maringlen Dani, Edmond Duriçi, Arian Pasha, Fllanxa Losha, Behar Cani, Arjan Hoxha, Veap Halili. Hap mbledhjen e radhës Arben Çupi. Diskutohet për rendin e ditës. Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshimet. Hiqet pika 9 nga rendi i ditës dhe të shtohet projektvendimi i agjencisë së funksioneve të transferueshme. Miratohet me 12 vota pro dhe 1 kundër. Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së datës 27.2.2026 dhe miratohet me 12 vota pro, 1 kundër Veap Halili. Tek të ndryshme, Maringlen Dani diskuton për rrugën e lagjes së re pasi ajo vazhdon të jetë e mbyllur. Kryetarja thotë që do ta shikojmë. Veap Halili thotë për petitionin që kanë bërë banorët e fshatit Fushë Bulqizë në lidhje me Hec Shytaj. Është marrë dokumentacioni dhe do të shqyrtohet mbledhjen e radhës. Veap Halili thotë që kanë marrë ankesa nga disa qytetarë për pallatet. Z.Haxhi Pulja thotë që kemi disa raste që kanë sjellë vetë banorët. Në disa raste ka mundësi për ndërhyrje. Veap Halili thotë që brenda mundësive të bëhet diçka. Lexohet projektvendimi për 6% e të muajit janar. Prezanton Korab Kika. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Lexohet projektvendimi për bonus qiraje. Prezanton Korab Kika. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro, dy abstenim. Projektvendim për rishikimin e programit të transparencës. Prezanton Gerta Jella, tregon ndryshimet që janë bërë. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro dhe dy kundër, Veap Halili dhe Flanxa Losha. Projektvendim për parashikimin e të ardhurave të PBB-së 2027-2029. Prezanton Rakip Hoxha, shpjegon për llojet e taksave. Maringlen Dani pyet për taksën familjare pasi në projekt lexojnë rritje. Zoti Rakip Hoxha thotë që bëhet fjalë për shtrirje. Pra që aty ku ka ndriçim do të thotë do të paguajnë taksën e ndriçimit. Munir Sinani thotë që nëse ka ndonjë mënyrë që taksa e subjekteve minerare të ardhurat të vijnë në Bashki Bulqizë. Nga 9% e rentës minerale, 5% i merr bashkia. Këto varen nga Kuvendi i Shqipërisë, pasi aty bëhen ndryshimet në ligje. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro. Projektvendim për një ndryshim të vendimit nr 90 datë 10.12.2025 për miratimin dhe numrit të pergjithshem dhe nivelin e pagave të funksionareve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësit civil dhe të punonjësit administrativ për Bashkinë Bulqizë. Veap Halili thotë për një ndryshim tek Komisioni i Ekonomisë, për ndryshimin e sekretarit të komisionit. Veap Halili pyet për numrin e punonjësve të gjendjes civile duke qenë se janë shkurtuar, por numri është i plotë. Zonja kryetare thotë që ato janë në punë deri më 31 mars. Hidhet në votim me 11 vota pro, dy kundër, Veap Halili dhe Fllanxa Losha. Projektvendim i Agjencisë së funksioneve të transferueshme, për nivelin e pagave, prezanton Haxhi Pulja. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro, dy kundër, Veap Halili dhe Fllanxa Losha. Për pikën 10 dhe 11 janë refuzuar nga komisioni, si dhe pika 12 dhe 13 nuk shqyrtohen.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mynir Sinani, Greta Tanci, Valbona Jani, Behar Çani, Gëzim Xhafa, Edmond Duriçi, Maringlen Dani, Fllanxa Losha, Arben Çupi, Arjan Hoxha.

Mbajtësi i procesverbalit

Sekretari i Këshillit, Klodian Reçi.

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 07.04.2026 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Bulqizë, mbledhje e shtyrë për mungesë kuorumi e datës 03.04.2026. Marrin pjesë këshilltarët: Gëzim Xhafa, Valbona Jani, Arben Çupi, Greta Tançi, Maringlen Dani, Munir Sinani, Ernold Çupi, Edmond Duriçi, Arjan Pasha, Endrit Meta, Behar Cani, Shkëlqim Begu, Shaqir Manjani, Veap Halili, Elkier Duriçi, Ylli Xhafa, Arjan Hoxha.

Hap mbledhjen Arben Çupi. Lexon rendin e ditës. Z. Shaqir Manjani thotë që ka bërë tre kërkesa për informacion, shkarkimin e sekretarit dhe autorizimin për dëgjesat publike. Z. Arben Çupi thotë që kërkesat kanë ardhur sot dhe përgjigja do të merret në afatet ligjore. Zoti Shaqir Manjani pyet për konsultimin në Gjorice dhe të tjerat. Kryetarja Festime Mjeshtri thotë që unë jam me banorët dhe nuk merren vendime nëse banorët nuk janë dakord. Zoti Munir Sinani thotë që sekretari varet nga Këshilli Bashkiak dhe që në dëgjesa duhet të jenë edhe anëtarë të tjerë të Këshillit. Z. Endrit Meta thotë që ne jemi me banorët. Z. Arben Çupi thotë që jemi 10 minuta pushim për shkak të situatës së krijuar në sallë. Banorët kërkojnë informacion për dëgjesën publike në lidhje me firmat. Z. Klodian Reçi thotë që në bazë të kërkesave nga Drejtoria e Pyjeve vendosen datat për dëgjesat publike. Në çdo njësi janë njoftuar administratorët, banorët. Duke qenë se banorët nuk kanë qenë dakord, nuk është marrë asnjë firmë e tyre. Z. Shaqir Manjani thotë që duhet të ketë autorizim nga kryetari i Këshillit për dëgjesat publike. Z. Shaqir Manjani kërkon të mbyllet mbledhja dhe diskutohet për vazhdimësinë e saj. Z. Arben Çupi hedh dhe votim rendit të ditës. Miratohet me 11 vota pro, dy kundër. Zoti Arben Çupi vazhdon me rendin e ditës, për të kaluar në votim secilin prej projekteve bashkë me ndryshimet.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit shkurt 2026, datë 09.03.2026. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro, dy kundër. Projektvendim për 6%-shin, prezanton Korab Kika. Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro. Ndihmë financiare për z. Indrit Zogu, prezanton Korab Kika. Hidhet në votim me 13 vota pro, një abstenim. Për bonus qeraje znj. Aurela Hyra, familje në nevojë. Prezanton Korab Kika. Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro. Për projekt vendim për dhënie titulli qytetar nderi për znj. Vera Laçi, prezanton Marsida Murja. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro, dy abstenim, një kundër. Projektvendim për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të BBA-së 2026-2028, pasi kaloi në komision, hidhet në votim me 11 vota pro. Projektvendim për raportin e monitorimit të Bashkisë Bulqizë 2025, janar-dhjetor. Prezanton Matilda Isaku. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro. Projektvendim për disa shtesa në VKB nr.100, për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026. Prezanton Matilda Isaku. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro.

Pika 9. Projektvendim për heqjen dhe dhënien e përdorim të sipërfaqes pyjore kullimore me qëllim hedhjen e sterilizimit të kromit sipas lejes minerare 1030/1., datë 28.01.2028, prezanton Shaqir Izvira. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro.

Pika 10. Projektvendim për miratimin me shkrim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullisor me qëllim hedhjen e sterilizimit të kromit sipas ligjit mineral 946/1, datë 17.06.2006. Pika 11. Projektvendim për miratimin e fondi për ndihmë shtetërore financiare për zotin Besnik Basha. Prezanton Selim Alliu. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro.

Projektvendim për miratim fondi për ndihmë financiare për z. Zenel Demiri. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro.

Projektvendim për miratimin e planit të mbarshimit për ekonominë pyjore Zerqan. Prezanton Shaqir Izvira. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro.

Zoti Arben Çupi deklaroi mbledhjen e mbyllur.

Valbona Jani, Gëzim Xhafa, Shkëlqim Begu, Arben Çupi, Behar Çani, Maringlen Dani, Arjan Hoxha, Greta Tançi, Ernold Çupi, Edmond Duriçi, Endrit Meta.

Mbajtës i procesverbalit, Klodian Reçi.

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 11.5.2026 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë., mbledhje e shtyre e dates 8.5.2026.

Marrin pjesë këshilltarët, Munir Sinani, Arben Çupi, Greta Tanci, Raviola Kaja, Brulind Sinani, Ernold Çupi, Maringlen Dani, Endrit Meta, Elkier Duriçi, Veap Halili, Arjan Hoxha, Edmond Duriçi, Gëzim Xhafa, Behar Çani. Z. Arben Çupi hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës.

Zoti Veap Halili thotë që orari i mbledhjes të jetë më vonë pasi jemi në punë, si dhe për komisionin e rregullores që të mblidhen. Hidhet në votim miratimi i rendit të ditës dhe miratohet me 12 vota pro, dy kundër, Vep Halili dhe Elkier Duriçi. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar hidhet në votim me 12 vota pro, dy kundër, Veap Halili dhe Elkier Duriçi. Z. Endrit Meta shpreh shqetësimin për një shtëpi në Lladomericë e cila është e shkatërruar për zonjën Sedike Balaj. Trotuarin për unazën e vjetër për Drejtorinë e shërbimeve publike. Propozohet që njëri krah të bëhet me trotuar që të shërbejë për komunitetin. Dëshiron që të merret parasysht si kërkesë dhe të ketë një përgjigje për mbledhjen e radhës. Veap Halili kërkon kthimin e përgjigjeve për kërkesat. Flet për kanalin vaditës së fshatit Vajkal, nëse ka mundësi të një zgjidhje të përkohshme. Edmond Duriçi lexon kërkesën që banorët e fshatit Vajkal kanë bërë për hapjen e një rrugë ekzistuese që të lëvizin makinat për të kryer shërbime të ndryshme. Kryetarja Festime Mjeshtri thotë që do të shikohet nga zyra e urbanistikës dhe të bëhen verifikimet e nevojshme. Hidhet në votim me 13 vota pro. Behar Cani thotë që fondi i zhvillimit ka sjellë llampa për ndriçim dhe në Gjorice nuk ka. Kryetarja thotë që brenda qershorit do ta rregullojmë.

Për kryeplakun e fshatit Vajkal kërkon zgjedhje dhe për kanalin e vaditës në lagjen Allmete nga Elkier Duriçi.

Lexohet projektvendimi për fondin 6% për muajin mars 2026. Prezanton Korab Kika. Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro.

Projektvendim për miratimin e fondit për ndihmë financiare për z. Behar Krajka, prezanton Korab Kika. Në komisionin e ekonomisë është lënë që ndihmat të jenë për të dy personat njësoj. Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro, dy abstenim, Veap Halili.

Projektvendim për ndihmë financiare për z. Mentor Shehu, hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro.

Projektvendim për ndihmë shtetërore financiare për zotin Ramiz Dervishi, prezanton Selim Alliu. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro, një abstenim, Veap Halili.

Projektvendim për ndihmë shtetërore financiare për z. Mehmet Mura, prezanton Selim Alliu. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro, një abstenim, Veap Halili.

Projektvendim për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare për znj. Zelig Shyti, hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro, një abstenim, Veap Halili.

Z. Arben Çupi deklaron mbledhjen të mbyllur.

Munir Sinani, Arjan Hoxha, Arben Çupi, Brulind Sinani, Greta Tanci, Raviola Kaja, Endrit Meta, Edmond Duriçi,

Sekretar i Këshillit, Klodian Reçi

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 29.05.2026 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë për mbledhjen e muajit Maj.

Marrin pjesë këshilltarët:

Arben Çupi, Arjan Hoxha, Behar Cani, Shkëlqim Begu, Ylli Xhafa, Elkier Durici, Edmond Durici, Maringlen Dani, Ernold Çupi, Visjana Limani, Rovjola Kaja, Brulind Sinani, Fllanxa Losha.

Hap mbledhjen e radhës Z. Arben Çupi. Lexon rendin e ditës. Hidhet në votim me 10 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit Prill 2026, datë 11.05.2026. Hidhet në votim me 10 vota pro, 4 kundër.

Tek të ndryshme lexohen dy kërkesa për ndihmë financiare për Emiljano Tanci dhe Hajrulla Disha.

Z. Arjan Hoxha pyet cilat janë mundësitë për të marrë ndonjë ndihmë financiare. Z. Vilson Sule thotë që do të shikohet nga fondi i Bashkisë për të shikohet edhe nga buxheti i Këshillit.

Z. Shaqir Manjani thotë që duhen 11 vota pro për rendin e ditës.. Kërkesat e dy familjeve në nevojë do t'i kalohen zyrës përkatëse me propozim 10 milion lekë të vjetra që të ndahen sipas mundësive, në propozim i Këshillit.

Tek rruga Unaza të shikohet rruga pasi makinat po prishin gomat edhe është problem.

Z. Shkëlqim Begu thotë çfarë do të bëhet me pallatet e dëmtuara nga tërmeti, pasi s'ka asnjë vendim apo informacion. Z. Albin Bodini thotë që janë shpallur të pabanueshëm. Rikonstruksion nuk mund të bëhet. Sa për ndërtim është e papërballueshme. Thotë që mund të bëjë një vlerësim të dëmit që t'ju jepet një shumë si në rastet e djegieve. Ne kemi bërë kërkesa në Ministri por deri tani nuk kemi asnjë financim. Në moment që kalojmë 2 vite çështje u kalon emergjencave civile të cilët japin 50% të vlerës. Z. Shaqir Manjani thotë që t'i dërgohet në email vendimi i ekspertëve.

Tek të ndryshmet: Z. Shkëlqim Begu pyet për vijëzimet vijat e bardha pasi janë në buxhetin e këtij viti por nuk janë bërë akoma. Z. Albin Bodini thotë që do të bëhen.

Z. Fllanxa Losha ngre shqetësimin e pusetat e ujërave të zeza. Ka 2 vite që janë pa kapak dhe nuk ka ardh njeri. Jemi paraqitur edhe në institucione por nuk janë marrë masa.

Projekt vendim për 6% për muajin Prill 2026. Hidhet në votim me 10 vota pro, 3 abstenim.

(Nënshkrimet dhe emrat):

Brulind Sinani Rovjola Kaja Visjana Limani Ernold Çupi Arjan Hoxha

Arben Çupi Behar Cani Edmond Durici Maringlen Dani

Sekretari: Klodian Reçi